VENDIM
Nr.659, datë 11.6.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS ZERQAN TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Zerqan të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Zerqan, të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.94, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Zerqan të qarkut të Dibrës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Zerqan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Zerqan Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
10-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
597,598,604,605,609,610,613, 614,618,619,623,624,629, 630,635,636,640,644,645,646, 651,652,656,657,662,663	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
599,600,601,606,607,615, 616,620,621,625,626,631, 632,637,638,641,642,647, 648,649,653,658,659,664, 628,634,655,661,603,608, 612,617,622,627,633,639, 643,650,654,660,665,602,611	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta).	Në pronësi